

Ne perputhje me Nenin 28, paragrafi i 3-te i Ligjit 97/2007, Per Qendren Kombetare te Regjistrimit, ky dokument perben:

**AKT THEMELIMI  
DHE  
STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“LEXON” SH.P.K.**

Sot me date 01 Korrik 2025, palet e meposhtme:

**Z.Kliti HOTI**, atesia Sami dhe amesia Adlije, lindur me 15.04.1970 ne Shkoder e banues ne Shkoder ne adresen: Rruga Nazmi Kryeziu 03310304, Nd. 47, H. 1, Shkodër; 4001, Shkodër, mbajtes i leternjoftimit nr. 033628774 me nr.personal H00415267W; dhe

**Zj.Edite SADIKU**, atesia Tahir dhe amesia Elisabeta, lindur me 01.03.1974 ne Shkoder e banuese ne Shkoder ne adresen: Rruga Nazmi Kryeziu 03310304, Nd. 47, H. 1, Shkodër; 4001, Shkodër, mbajtes i leternjoftimit nr. 037962626 me nr.personal H45301245B.

vendosin te nenshkruajne kete Akt Themelimi dhe Statut per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**KAPITULLI I  
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqeria “LEXON” Sh.p.k. (ne vijim “Shoqeria”) krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.
- 1.2. Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.


**Neni 2 – Emertimi**

- 2.1 Emertimi i Shoqerise eshte “LEXON” Sh.p.k..

**Neni 3 – Objekti i shoqerise**

- 3.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte: Shoqeria ka per objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve tregtare në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi. Me specifikisht:
  - Themelimi dhe krijimi i shoqerive dhe siper marrjeve shqiptare dhe te huaja si dhe pjesemarrja ne to, administrimi dhe drejtimi i shoqerive tregtare dhe siper marrjeve vendase apo te huaja;
  - Blerja apo disponimi mbi pjesemarrjen e kapital ne korporata, partneritete apo shoqeri e sindikata me objekte aktiviteti te ndryshme, blerja dhe shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesemarrje te tjera ne siper marrje dhe shoqeri, brenda kufijve te lejuar nga legjislacioni i aplikueshem;
  - Blerja, barresimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive te paluajtshme dhe atyre te luajtshme si dhe titujve;
  - Pjesemarrje ne shoqeri me objekte aktiviteti ne fushen e ndertimit, turizmit, investime ne energjitike, imobiliare, ne lojra fati etj;
  - Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje dhe te realizoje cdo aktivitet qe lidhet direkt apo indirekt, eshte si rrjedhim apo ka te beje me objektivat e renditura me siper.
- 3.2 Per te arritur qellimin e mesiper shoqeria mund te ndermarre veprime me pasurite e luajtshme apo te paluajtshme dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, per dhenie me qira apo hipotekim qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet objektivi i shoqerise.

**Neni 4 – Selia**



- 4.1. Selia e Shoqerise eshte: Njesia Bashakiake Nr. 2, Rruga "Beqir Luga", Pallati i Ri, Ap.4, Zona Kadastrale 8150, Tirane, Shqiperi.
- 4.2. Transferimi i selise se Shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.
- 4.3. Asambleja e Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

#### **Neni 5 – Kohezgjatja e veprimtarise**

- 5.1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar.
- 5.2 Shoqeria mund te priset perpara ketij afati ose mund te ndryshoje kohezgjatjen e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

### **KAPITULLI II**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

##### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1,000 (nje mije) Leke.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuota e gjitha e nenshkruara dhe e shlyera, me vlere nominale 510 Leke (peseqindedhjete Leke) dhe 490 Leke (katerqindenentedhjet Leke).

##### **Neni 7 - Kontributet**

- 7.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:
  - **Z.Kliti Hoti** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 510 Leke (peseqindedhjete Leke) ne favor te shoqerise ne themelim e siper.
  - **Zj.Edite Sadiku** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 490 Leke (katerqindenentedhjet Leke) ne favor te shoqerise ne themelim e siper.
- 7.2 Sipas kontributeve te mesiperme:
  - **Z.Kliti Hoti** zoteron 1 (nje) kuote qe i korrespondon me 51% (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit te Shoqerise;
  - **Zj.Edite Sadiku** zoteron 1 (nje) kuote qe i korrespondon me 49% (Dyzet e nente perqind) te kapitalit te Shoqerise.

##### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**


- 8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakut te Ortakeve.
- 8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara. Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

##### **Neni 9 – Zvogelimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

##### **Neni 10 – Transferimi i kuotave**

- 10.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.
- 10.2 Ne rast transferimi ne çdo lloj forme, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim ne kuptimin me te gjere te fjales, duke perfshire ketu edhe dhurimin ne favor te subjekteve te tjere te ndryshem nga ortaket, kuotat duhet me pare t'i ofrohen ne parablerje ortakeve te tjere.
- 10.3 Ne nje rast te tille ortaku qe do te transferoje kuoten e tij duhet te njoftoj ortaket e tjere, me leter rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin per shitje, duke percaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blesesit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet te gjitha kuotave te ofruar per shitje.
- 10.4 Ortaket do te kene ne dispozicion 15 (peseumbedhjete) dite nga marrja e letres rekomande, per t'i



komunikuar ortakut qe transferon kuotat, synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.

- 10.5 Ne rast se oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e ofruara nga ortaku qe transferon kuotat, do te ndahen nga ortakët pranues, ne te njejten mase me kuotat qe ata zoterojne, perveç rastit kur ka nje marreveshje te kundert. Ne asnje rast, pranuesi i ofertes nuk mund te ushtroje pjeserisht te drejten e parablerjes.
- 10.6 Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin pozitiv te Asamblese se Ortakeve.
- 10.7 Ne rast te transferimit te kuotave per shkak trashegimie *mortis causa* ortakët e tjere kane te drejte te shprehin pelqimin e tyre per ortakët e rinj. Ne rast se nuk jepet pelqimi, kuotat mund t'u transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin pozitiv te Asamblese se Ortakeve.

### **KAPITULLI III**

#### **ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL**

##### **Neni 11 – Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendim-marres i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.
- 11.2 Asambleja e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per çeshtjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimi e shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel e likuidatoreve, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, miratimi i bilancit dhe per çdo vendim tjeter parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni perkates.

##### **Neni 12 – E drejta e pjesemarrjes dhe e votes**

- 12.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i kuotave qe ai zoteron.
- 12.2 Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles mund te jape voten e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

##### **Neni 13 – Thirrja e Asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve, Kuorumi dhe Vendimet**

- 13.1 Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel sidhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund te thirret ne çdo moment nga nje prej Administratoreve sidhe prej nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit themeltar. Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve – ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve – dhe ekspertit kontabel (nese eshte emeruar), te pakten 15 (pesembedhjetë) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, mbi çeshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.
- 13.3 Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise, brenda apo jashte Republikes se Shqiperise.
- 13.4 Ne rast se Asambleja e Ortakeve nuk mblidhet me thirjen e pare per mungesen e kuoromit te parashikuar ne piken 13.7 te ketij Statuti, Asambleja e Ortakeve do te thirret brenda 30 (tridhjetë) ditesh me te njejtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikohen dhe t'u lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te çeshtjeve ne rend te dites; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortakët qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblese se Ortakeve, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese

jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se Ortakeve qe kerkojne nje shumice te cilesuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne te pakten 51% (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar.

- 13.8 Asambleja e Ortakeve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, me voten pro te  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e ortakeve te pranishem qe zoterojne te pakten 51% (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar. Ne te gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakeve merr vendime me shumice te thjeshte votash te ortakeve qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga vete Asambleja. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emerone nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

#### **Neni 14 – Administrimi**

- 14.1 Shoqeria administrohet nga te pakten 1 (nje) Administrator i cili do te qendroje ne detyre deri ne shkarkim apo doreheqje ose per nje periudhe prej 5 (pese) vitesh. Administratori i pare i Shoqerise eshte emeruar **Brendi Hoti**, atesia Kliti, lindur me 28.07.1997 ne Shkoder e banues ne Shkoder, mbajtes i pasaportes nr. BJ8308292 me nr.personal J707280591.
- 14.2 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i besohet Administratorit. Administratori mund te ushtroj te gjitha fuqite konform me sa parashikohet ne nenin 95 te Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.
- 14.3 Administratorët mund te emerone perfaqesues te posaçem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.

#### **Neni 15 – Eksperti kontabel i autorizuar**

- 15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakut te Vetem/Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje ose disa eksperteve kontabel te autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE**

##### **Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**


- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.
- 16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.
- 16.4 Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

##### **Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.
- 17.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

### **KAPITULLI V SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

##### **Neni 18 – Prishja**



- 18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.
- 18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

#### **Neni 19 – Likuidimi**

- 19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.
- 19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit te kreditorëve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

#### **Neni 20 - Zgjidhja e mosmarreshjeve**

- 20.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te interesuara.
- 20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreshjes, ato do t'i besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### **Neni 21 – Gjuha**

- 21.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut eshte hartuar ne 2 (dy) kopje ne gjuhen shqipe.

\* \* \*

### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE “LEXON” SHPK**

**Kliti HOTI**



**Edite SADIKU**

